



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 12.05.2015 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Time Kadrijaj, Arben Gashi, Valdete Bajrami, Luljeta Veselaj- Gutaj, Ilir Deda dhe Slllobodan Petroviq.

Munguan : Rustem Mustafa dhe Kujtim Paçaku.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

I ftuar: z. Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S:

.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.4.2015;**
- 3. Raportim i z. Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja e Komisionit, znj. Teuta Sahatqija, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen dhe kaloi në pikën e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.4.2015**

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Kryetarja, Teuta Sahatqija, falënderoi ministrin për dërgimin e raportit me shkrim, me kohë dhe tha se jeni ftuar për të raportuar lidhur me sfidat e dala nga Raporti i Progresit dhe lidhur me ecuritë e reformës në administratën publike, duke pas parasysh se reforma e administratës publike përmendet në çdo dokument ndërkombëtar. Në vazhdim, ia dha fjalën ministrit.

Ministri, Mahir Yagcillar, falënderoi për ftesën dhe pasi që e ka dërguar raportin me shkrim, tha se do t'i paraqesë disa pika më të rëndësishme dhe sqarime, sa i përket reformës në administratën publike, në aspektin e integriteteve evropiane dhe Raportit të Progresit dhe pastaj do t'ju lë vendin pyetjeve të deputetëve.

Ai theksoi se Ministria e Administratës Publike ka analizuar në hollësi Raportin e Progresit për vitin 2014 dhe janë nxjerrë sfidat, rekomandimet dhe plani për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve që dalin nga raporti. Reforma e administratës publike (RAP) ka filluar para pavarësisë dhe pas pavarësisë, si dhe vazhdon në disa faza. Janë plotësuar strategjitë dhe strategjia e fundit 2009-2013, e cila ka vënë themelet e reformës së administratës publike.

Në vitin e kaluar, së bashku me Komisionin Evropian, hartuam Udhërrëfyesin për vitin 2014, ndërsa për 5 vitet e ardhshme, do të hartojmë një strategji e cila prapë do t'i përfshijë reformat, sepse ato gjithmonë vazhdojnë, por prioritet do të jetë modernizimi i administratës publike. Në këtë aspekt, është hartuar Udhërrëfyesi 2014, si dokument plotësues për të përmbushur boshllëkun e dokumentit strategjik, sa i përket RAP-it, deri në hartimin e dokumentit të ri afatgjatë për RAP-in . Përveç raporteve periodike për zbatimin e Udhërrëfyesit 2014, është hartuar edhe raporti gjithëpërfshirës për zbatimin e tij.

Me qëllim të shtyrjes para të procesit të RAP-it, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për themelimin e Këshillit të Ministrave për Reformën e Administratës Publike, si dhe përcaktimin e Kornizës së RAP-it. Kjo trupë është përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të RAP-it, si dhe monitorimin e procesit në tërësi. Gjatë këtij viti, Këshilli ka mbajtur dy takime dhe së shpejti presim ta mbajmë edhe takimin e tretë, i cili do t'i paraprijë grupit të veçantë për reformën e administratës publike, bashkë me Komisionin Evropian, ndërsa strukturat organizative të RAP-it, pas formimit të Këshillit, në shkurt të vitit 2015, është aprovuar struktura administrative përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe koordinimin e procesit të dokumenteve strategjike nga korniza e RAP-it dhe procesit të RAP-it në tërësi.

Qeveria e Kosovës ka krijuar një qasje të re ndaj proceseve të RAP-it, duke ndarë procesin në tri fusha kryesore, brenda kornizës së RAP. E njëjta është në harmoni të plotë me konkluzionet e takimit të ministrave për administratë publike në Bruksel, si dhe parimeve të SIGMA-s për administratë të mirë. Lidhur me këtë, janë bërë tri kategori kryesore:

1. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave dhe legjislacionit;
2. Strategjia për modernizimin e administratës publike (SMAP), dhe
3. Menaxhimi i financave publike.

Ministria e financave ka hartuar strategjinë e kontrollit të brendshëm të financave publike për vitin 2015-2019 dhe e njëjta është aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, janë disa ligje themelore të administratës publike, siç janë: Ligji për shërbimin civil dhe Ligji për pagat e nëpunësve civilë, si dhe janë nxjerrë 24 akte nënligjore, janë aprovuar të gjitha rregulloret, sa i përket zbatimit, por pjesa të Ligji për pagat e nëpunësve civilë, ende nuk është në funksion të plotë, sidomos nga aspekti i koeficienteve, të klasifikimi të vendeve të punës, që jemi duke punuar. Katalogu i vendeve të punës është aprovuar dhe do të jetë katalog i cili për herë të parë është miratuar në Kosovë, ku do të përfshihen të gjitha pozitat dhe koeficientet, bashkë me zbatimin e Ligjit për pagat e nëpunësve civilë dhe Ligjit për pagat e përgjithshme, i cili pritet të aprovohet në Qeveri dhe të dërgohet në Kuvend, ku pastaj katalogu do të jetë funksional.

Sa i përket strategjisë së trajnimeve, është hartuar draft-strategjia e re e trajnimeve për nëpunësit civilë 2015 -2019. Me këtë dokument, synohet të përcaktohet vizioni i zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve sipas nevojave të administratës publike, ndërsa UNDP dhe IKAP, së bashku do të sigurojnë trajnime. Në raport janë paraqitur tabelat me përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve në administratën publike dhe të gjitha informatat janë bazuar sipas informatave që i kanë dërguar institucionet veç e veç. Tani nuk e kemi mekanizmin për të vërtetuar saktësinë e të dhënave, por në të ardhmen, me funksionalizimin e plotë të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, do të kemi në çdo moment informata pa kërkuar informata nga institucionet, sepse të gjitha informatat do të jenë të postuara në këtë sistem. Sa i përket riorganizimit të administratës shtetërore, Qeveria e Kosovës ka vazhduar me organizimin e saj, ku deri më tani ka përfunduar riorganizimin e të gjitha ministrive. Deri më tani, kanë kaluar procesin e riorganizimit rreth 14 organe vartëse të ministrive. Ligji i procedurës administrative është hartuar në bashkëpunim me SIGMA-n, ka kaluar në Qeveri dhe pritet së shpejti të dorëzohet edhe në Kuvend për miratim. Për Projektligjin për pagat, kemi filluar debatet e brendshme në nivelin qeveritar dhe pastaj edhe në nivele tjera, dhe pas miratimit në Qeveri dhe procedimit në Kuvend, do të kemi një ligj të unifikuar për të gjitha pozitat, që janë përfitues nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Sa i përket e-Qeverisjes, me formimin e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, ka filluar një koordinim më i mirë, sa i përket projekteve dhe bashkëpunimit në teknologjinë informative, që të krijohet një qasje elektronike, dhe gjithashtu, administrata publike të jetë e bazuar me zhvillimet e teknologjisë informative. Me përfundimin e projektit të qendrës së dhënave shtetërore, do të krijohet mundësia që shumë më shumë informata të postohen në këtë qendër.

Sa i përket forcimit të kapaciteteve në administratën publike, Instituti i Kosovës për Administratë Publike, gjatë vitit 2014, ka trajnuar 2068 nëpunës civilë, mirëpo nuk jemi të kënaqur, sepse nuk mund të ofrohet sistem më i avancuar i trajnimit, sepse hapësirat nuk janë të përshtatshme, por besojmë që së shpejti do të realizohet projekti i BE-së, ndërsa Ministria e Administratës Publike do ta realizojë pjesën e ndërtimit dhe pastaj do të krijohen hapësira të mjaftueshme dhe kushte për t'u zhvilluar trajnime të avancuara. Tani jemi duke diskutuar për trajnimet e obligueshme të shërbyesve civilë.

Kurse, sa i përket projekteve të ndërtimit dhe inxhinierisë, që indirekt kanë ndikim në administratën publike, janë realizuar shumë objekte, por mbetet të vazhdohet me objekte për akomodimin e institucioneve, ku edhe në Raportin e Progresit ka vërejtje lidhur me akomodimin e institucioneve. Me përfundimin e objektit të Pallatit të Drejtësisë, ku janë vendosur shumica e institucioneve, dhe në ditët në vijim, pritet të bartet edhe Gjykata Kushtetuese, kurse në objektin aktual të Gjykatës Kushtetuese, do të vendoset Institucioni i Avokatit të Popullit.

Kryetarja, në vazhdim, parashtroi disa pyetje për ministrin:

1. Në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit për vitin 2015, është paraparë kompletimi i kornizës ligjore për reformën e administratës publike. Ju përmendet disa ligje që kanë të bëjnë me administratën publike. A mendoni se ashtu siç është paraparë në këtë dokument, gjatë vitit 2015, mund të përfundohet me kompletimin e kësaj kornize ligjore?

2. A keni planifikuar buxhet dhe kapacitete të mjaftueshme për zbatimin e draft- strategjisë së trajnimeve për nëpunësit civilë?

3. Në PVRP-të është paraparë që në tremujorin e parë të vitit 2015, të përfundojë Sistemi i menaxhimit të informatave të burimeve njerëzore në shërbimin civil të Kosovës. A është përfunduar ky sistem apo jeni në përfundim e sipër?

4. Në tabela, shihen ndarjet sipas përkatësisë etnike, më intereson a keni bërë nga aspekti gjinor ndonjë analizë në formë tabelore?

5. Ju i përmendet fondet nga IPA II, a keni marrë projekte dhe a keni kapacitete njerëzore, të cilët do të jenë në gjendje të absorbojnë IPA-fondet?

6. A mundeni të na informoni më në detaje lidhur me kushtet e punës, si dhe si ka vajtur ecuria e mbikëqyrjes së punimeve në Pallatin e Drejtësisë, sepse është raportuar se ekzistojnë pakënaqësi lidhur me kushtet e punës, sepse janë paraqitur disa probleme?

Ilir Deda, pyeti se cilat janë sfidat objektive për reformën e administratës publike në Kosovë, që 13 vite punohet për reformë të administratës publike dhe më duket se jemi vend i dështuar në krahasim me rajonin dhe administrativisht më të dobëtit. Çka po ndodh?

Në vitin 2008 -2009, një projekt i DFD, i cili ka pasur të bëjë me rishikimin funksional në administratë, ka nxjerrë disa konkludime dhe një prej vërejtjeve për Kosovën është se administrata është shumë e madhe. Çka nënkupton kjo në punën e juaj?

Si matet efikasiteti i nëpunësve civilë në kryerjen e obligimeve të veta? Tek ne ekziston një dobësi e madhe institucionale, sepse nuk respektohet e gjithë hierarkia institucionale.

Luljeta Gutaj-Veseli, tha se është folur shumë gjatë këtyre ditëve për katalogun dhe lidhur me këtë pyeti se sa pozita kanë ekzistuar para katalogut dhe sa pozita saktësisht i kemi sot për vendet e punës, si dhe pyeti se deri ku keni arritur me Projektligjin për nivelizimin të pagave.

Ministri, tha se sa i përket kompletimit të kornizës ligjore, mund të themi se është e plotësuar. Faktikisht, edhe në mandatin e kaluar, me aprovimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve, por gjithmonë ekziston nevoja për plotësim- ndryshim, dhe në këtë aspekt, në këtë vit propozuam plotësim- ndryshimin e Ligjit për shërbyesit civilë, sepse ka disa paqartësi sa i përket ndarjes së shërbyesve civilë, pra mos të ketë mendime të ndryshme, por te jetë ndarja e qartë në aspektin ligjor. Gjithashtu, edhe Ligji i administratës shtetërore, krijon duplikim të kompetencave mes institucioneve dhe kjo çështje duhet të qartësohet. Po ashtu, është planifikuar të bëhen këto ligje, si dhe organizimi sa i përket agjencive dhe institucioneve të pavarura, sidomos është një paqartësi sa i përket organizimit të atyre institucioneve që janë në vartësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës, a do të bëhet një standard, do ta shohim me miratimin e Ligjit për administratën shtetërore.

Sa i përket zbatimit të Ligjit për paga të nëpunësve civilë, nuk është duke u zbatuar nga aspekti i vlerave të pagesës. Vlerësimi i punës dhe çështja e konkurrencës dhe shumë çështje të tjera, janë të rregulluara me aktet nënligjore dhe janë duke u zbatuar, por sistemi i pagesës ende është me sistemin e vjetër, por besoj se me miratimin e ligjit për pagat e përgjithshme, prapë do të vazhdojmë që nëpunësit civilë të përfshihen edhe në këtë ligj dhe pagesa për të njëjtën punë të jetë e njëjtë me koeficient dhe vlerësim. Korniza ligjore është kompletuar dhe këto çështje janë sa i përket hapave të shkurtër të MSA-së .

Sa i përket IKAP-it, buxheti nuk mjafton, por me rishikim të buxhetit dhe me përkrahjen tuaj, do të shikojmë ta bëjmë rritjen e buxhetit për trajnimet e avancuara.

Me fondet e IPA-së, është hartuar projekti për ndërtim të objektit, por në mungesë të sigurimit të truallit, ende nuk kemi filluar. Para dy javësh, në Komunën e Prishtinës është marrë vendim për ndarjen e truallit për ndërtesën e IKAP-it dhe ndërtesave tjera, por ai vendim duhet të kalojë përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe pastaj të vazhdohet te ne, dhe nëse kjo përfundohet shpejt, edhe ne së shpejti mund ta fillojmë ndërtimin.

Sa i përket tabelave me përqindje etnike dhe gjinore, së shpejti në Kuvend do ta dërgojmë raportin mbi gjendjen në shërbimin civil, ku do të ketë më tepër tabela, sa i përket statistikave nga aspekti etnik, gjinor, kualifikimeve, moshës dhe çështje tjera.

E ritheksoj prapë se këto të dhëna statistikore në tabela janë nga institucionet veç e veç dhe nuk mund të japim garanci se janë të besueshme qind për qind, por te sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, projekti është i përfunduar, në bashkëpunim me Bankën Botërore, si pjesë e modernizimit të sektorit publik. Sistemi është i gatshëm, por vetëm duhet kohë për bashkëpunim të gjitha institucioneve që të veprojnë sipas kërkesave në Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Sa i përket IPA-projekteve, kemi një premtim nga BE-ja, nëse gjatë këtij muaji dhe muajit të ardhshëm, të përfundojmë hartimin e strategjive dhe dokumenteve dhe pastaj të fillojmë të hartojmë dhe zbatojmë një plan veprimi, bashkë me aspektet buxhetore, që të krijohet mundësia e përkrahjes së administratës publike, bashkë me fondet e BE-së.

Pallati i Drejtësisë ka probleme dhe projekti ka qenë i financuar dhe i mbikëqyrur nga Komisioni Evropian, ndërsa ne obligimet i kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë, që ta mbikëqyrim edhe gjatë fazës së ndërtimit dhe tash kemi obligim mirëmbajtjen e objektit, që nuk është e lehtë, sepse objekti është shumë modern, ka mungesa dhe vërejtje dhe ne jemi duke u munduar që me të gjitha kapacitetet dhe mundësitë buxhetore, t'i realizojmë të gjitha mangësitë, por na duhet bashkëpunim, mirëkuptim dhe përkrahje nga të gjithë.

Lidhur me pyetjen se cilat janë sfidat dhe objektivat në reformën e administratës publike, që të kemi një administratë moderne profesionale, e cila nuk varet nga politika, ai tha se, siç e dini, nuk ka standarde evropiane për administratën publike, por administrata publike duhet të jetë e gatshme t'i realizojë ato standarde në shumë fusha tjera, si në mjedis, çështje të brendshme dhe shumë çështje tjera. Në vitin e kaluar, në nivelin ministror, e kam pasur një takim dhe SIGM-a ka hartuar disa parime të administratës publike që nuk janë te obligueshme, por janë të preferuara të zbatohen nga shtetet që kanë synim anëtarësimin në BE. Projekti i DFD-it ka ekzistuar, dhe në njëfarë mënyre, edhe është realizuar në mandatin e kaluar. Në shumë ministri, janë aprovuar planet zhvillimore strategjike dhe është vazhduar me riorganizimin dhe hartimin e standardeve të organizimit të brendshëm, ndoshta të gjitha nuk janë realizuar, por një pjesë e madhe e projektit të DFD-it është zbatuar dhe është krijuar bindja sesi duhet organizuar administrata publike, por tani jemi në një fazë ku duhen të zbatohen parimet e administratës publike, hartuar nga SIGM-a dhe OCD për shtetet mandate.

Sa i përket efikasitetit të administratës publike, janë rregulloret për vlerësim të punës, janë edhe për menaxherët, edhe për punëtorët. Për këtë vit kërkuam që të bëhet vlerësimi i punonjësve dhe për këtë ka reagime pozitive, por edhe negative, sepse nuk kuptohen njëjtë. Është një problem se jemi duke e bërë vlerësimin, por nga ana tjetër, nuk e kemi filluar zbatimin e Ligjit për paga, sepse është një çështje e përbashkët, bëhet vlerësimi, kurse në anën tjetër, pagat nuk janë duke u zbatuar. Sa i përket shërbimeve administrative, filluam me projektin e hartuar nga Banka Botërore nga aspekti i licencave, ndërsa përmes GIZ-it dhe Departamentit të Reformës së Administratës Publike, formuam një data-bazë për shërbimet në administratën publike, si pilot-projekt, i cili është zhvilluar në nivelin e ministrive dhe disa komunave, por në fazën e dytë do t'i përfshijmë të gjitha institucionet të cilat kryejnë shërbimet administrative dhe pas krijimit të data-bazës dhe informatave, mund të krijojmë edhe një data-bazë, sa i përket indikatorëve të vlerësimit të cilësisë së shërbimeve administrative. Sa i përket hierarkisë, dihet se në bazë të organizimit dhe ligjeve, cili është roli dhe kompetenca e një shërbyesi civil dhe kompetenca e këshilltarit politik të ministrit. Këto çështje janë të rregulluara sipas disa ligjeve dhe rregulloreve. Po ashtu, duhet të gjithë ta kuptojmë se ku fillon dhe ku përfundon hierarkia, sa i përket shërbimit civil dhe kalon në fazën politike.

Katalogu i vendeve të punës është prapë një projekt i përbashkët me Bankën Botërore në fushën e modernizimit të sektorit publik. Në fillim, nuk është kërkuar nga BE-ja, por në raportin e fundit të progresit, është kërkuar dhe në muajin shkurt është miratuar në Qeveri dhe është një dokument mjaft dinamik. Këtu flitet vetëm për pozitat dhe në çdo ministri p.sh. një drejtor i një departamenti duhet ta ketë pagën e njëjtë. Ky katalog duhet të zbatohet, sepse është një dokument mjaft i rëndësishëm, në të cilin deri më tani janë fuzionuar afër 700 pozita. Me katalog as nuk shuhet ndonjë vend pune, por është fjala për pozita, ku për një pozitë mund të jetë një person, kurse për pozitën tjetër shumë persona. Katalogun e vendeve të punës, me rregullore, jemi te detyruar ta zbatojmë bashkë me Ministrinë e Financave, ku do të bëhet klasifikimi i vendeve të punës dhe do të përcaktohet edhe koeficienti. Katalogu as nuk krijon vende te reja te punës, as nuk e bënë shuarjen e ndonjë vendi të punës, por vetëm krijon një emërtim i cili do të jetë standard për të gjithë. Sa i përket Projektligjit për pagat për përfituesit nga buxheti i Kosovës, kemi filluar konsultime paraprake të brendshme qeveritare dhe pas dy javëve duhet të dërgohet në vlerësim të ndikimit financiar në Qeveri dhe pastaj në Kuvend për miratim. Është koha që pagat të jenë të unifikuara, duke filluar prej presidentes, e deri te pozita më e ulët, ku për të njëjtin kualifikim dhe të njëjtën punë që e kryen, të paguhet njëjtë, ndërsa specifikat dhe shtesat tjera, do të parashikohen edhe me ligj.

Vjosa Osmani, tha se pyetja e saj ka te bëjë me implementimin e marrëveshjes së 19 prillit, e njohur si Marrëveshja e Brukselit, e cila ndër të tjera parasheh edhe integrimin e strukturave administrative paralele në veri, më konkretisht sa është zbatuar kjo marrëveshje. Në këtë aspekt, neve na intereson se administrata që ka punuar ilegalisht dhe ka funksionuar në mënyrë paralele, dhe tashmë, a është integruar brenda institucioneve të Kosovës, nëse po, atëherë cilat kanë qenë sfidat dhe deri në çfarë mase keni arritur ta integroni atë administratë?

Në një raportim që e keni pasur në Komisionin Evropian, në mandatin e kaluar, një ndër problemet që u patë përmendur, ishte që ende ka njerëz që nuk jetojnë në Kosovë dhe paguhën nga administrata publike, kjo kryesisht i referohet përfaqësuesve të disa komuniteteve që kryesisht kanë jetuar në veri. - A keni ende raste të tilla, dhe nëse po, deri ku arrin numri përafërsisht?

Xhavit Haliti, u ndërlidh në lidhje me çështjen e të punësuarve në ministri të ndryshme në konkurrimin për pranim të punonjësve. Ju keni një praktikë që t'i shpallni konkurset për shumë vende të punës nga Ministria e Administratës Publike dhe këta punonjës që konkurrojnë, kalojnë në një proces të verifikimeve nga komisione të veçanta, qoftë në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike dhe ministrive të tjera. Dhe për koincidencë, disa ministra kur nuk iu konvenon klasifikimi për emra të veçantë që kanë për t'u pranuar, kërkojnë nga ju që ta anuloni konkursin dhe ta shpallni përsëri. Ky veprim nuk është i mirë dhe më shumë do ta lidhja këtë çështje, për shkak të mosplotësimit të appetiteve, qofshin ato politike apo nepotiste të ministrave përkatës, të cilët pa kurrfarë sqarimi kërkojnë nga ju që të shpallni konkurs të ri.

Mendoj që arsyetimi për t'u shpallur një konkurs i tillë dhe për të lënë dikastere të veçanta me ushtrues detyre, është krejtësisht i paarsyeshëm dhe nuk i shërben asaj që ne duhet ta quajmë kualifikim përkatës ose njerëzit i kanë kualifikuar personat që janë ngarkuar për t'i kualifikuar dhe për t'i ranguar, sa i përket përgjegjësi të tyre, ndodh që të zvarritet pranimi i përgjegjësve, derisa t'iu përshtatet dikush nga komisioni që të pranojë kërkesën e ministrit, pra që në dikaster të pranohet personi i caktuar. Nëse është kështu, atëherë ju nuk e kryeni detyrën mirë, sepse ju po pranoni nga ministrat që t'ju detyrojnë të rishpallen konkurset pa arsyetim, që për vendet përkatëse që ju e keni pasur një konkurs, të cilin e ka klasifikuar komisioni. Pra, janë çështje që kanë të bëjnë me akuza publike që janë edhe të institucioneve në përgjithësi apo të asaj që ne e quajmë nepotizëm ose punësim mbi bazat e varësisë politike.

-A keni inspektorë të kontrollit të të punësuarve në ministri dhe a ka të punësuar në ministri, që asnjëherë nuk kanë shkuar në vendin e punës dhe marrin rroga?

Sllobodan Petroviq, tha se pasi në raport, në tabela keni paraqitur përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve në administratën publike. Pyeti ministrin se a ka të dhëna se cilat janë ato pozita. E di se ky është problem i trashëguar, por gjithsesi dua të besoj që do ta jepni maksimumin, siç e keni shkruar edhe vetë në raport, që ajo përqindje të jetë në përputhje me ligjin.

Time Kadrjaj, u interesua të dijë se a ka të punësuar pa konkurs dhe të punësuar pa përshkrim të vendeve të punës. Në takimin e fundit që e keni pasur me homologun tuaj nga Shqipëria, a keni biseduar se sa do të jetë përkrahja e Shqipërisë për plotësimin e të gjitha atyre kritereve që na duhen për MSA-në? Pse punonjësit që punojnë në departamente të njëjta nëpër ministri të ndryshme, nuk i kanë pagat e njëjta? A po bëhet edhe tani evoluimi i punonjësve siç ka qenë më parë?

Në gjashtëmujorin e parë, ka qenë evoluimi formal, kurse pas një viti, ka qenë evoluimi tjetër, ku kanë qenë të përcaktuara kushtet dhe kriteret, në bazë të të cilave është vlerësuar puna e punonjësve në institucionet publike, sipas hierarkisë nëpër institucione.

Ministri, tha se sa i përket implementimit të marrëveshjes ose përfshirjes së punonjësve nga pjesa veriore, nëse bëhet me ligj, automatikisht duhet të zbatohet. Tani nuk kam informata konkrete. Marrëveshja e mirëkuptimit dhe listat e pagave, ka dy muaj që kanë kaluar në

Ministrinë e Financave, por prapë ekziston ekipi i cili ishte formuar me ministrin e Pushtetit Lokal, me zyrën administrative dhe me çështje tjera.

Vjosa Osmani, sqaroi se sa i përket inkuadrimin të personave nga veriu në institucionet e Kosovës, ky është obligim Kushtetues i Kosovës, që nga momenti kur është nënshkruar marrëveshja Kosovë- Serbi dhe nuk ka nevojë për ligje të tjera, sepse marrëveshja ndërkombëtare është mbi ligjet, çështja është vetëm se deri ku është zbatuar dhe për këtë duhet të njoftoni.

Ministri, edhe më parë thashë se nuk kam informata, sepse për këtë çështje më tepër është punuar në grupe të veçanta, përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal, sepse shumica e këtyre çështjeve nuk janë të shërbyesve civilë ose janë punonjës të komunave, ose të sistemit gjyqësor dhe ata e kanë sistemin pak më ndryshe. Për detaje tjera, nuk jam i informuar dhe nëse ekzistojnë statistika, do t'ua dërgoj me shkrim dhe do të japim sqarime përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Financave.

Sa i përket njerëzve që nuk jetojnë dhe punojnë në Kosovë dhe paguhen, deri më tani Ministria e Administratës Publike nuk e ka pasur Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ligji është vetëm për shërbyesit civilë, ndërsa fusha të tjera nuk kanë qenë të përfshira, ndoshta ekziston mundësia që ka pasur këso rastesh, por duhet të analizohet krejt sistemi i Payroll-it, për të nxjerrë dhe për të vërtetuar se a ka persona të përfshirë ose jo.

Sa i përket çështjes së të punësuarve në administratën publike, kjo çështje ka të bëjë vetëm me shërbyesit civilë dhe shëndetësi, policia, arsimit janë kategori ku ne nuk kemi ndikim, sepse ose shkohet drejtpërdrejt përmes ministrisë ose përmes komunave. Te shërbyesit civilë, janë dy lloj pranimesh, për zyrtarët e nivelit të lartë drejtues është procedurë që është e rregulluar me Ligjin për shërbyesit civilë dhe pastaj është e detajuar me rregulloren për zyrtarët e lartë të nivelit drejtues dhe për këtë pjesë, Këshilli Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, nuk ka kompetencë, nëse është vendi i lirë për zyrtarët e lartë drejtues, atëherë veprohet sipas ligjit dhe rregullore.

Xhavit Haliti, ndërhyri duke sqaruar se nuk mund të ketë edhe ligj, edhe rregullore, sepse aty ku ka ligj, nuk ka rregullore. Në administratë nuk ka edhe ligj, edhe rregullore. Ligji e heq rregulloren.

Ministri, tha se ligjin të cilin e kemi miratuar kur kam qenë edhe unë deputet, ka lënë mundësi që të krijohet edhe rregullorja e cila është bërë nga Zyra e Kryeministrit, që është edhe përgjegjëse e drejtpërdrejtë për zbatimin dhe interpretimin e rregullore. Në bazë të kësaj rregulloreje, Ministria e Administratës Publike, apo unë si ministër i Administratës Publike, me kërkesë të ministrit, kam për obligim të shpall konkurs, kurse pas konkursit formohet komisioni prej tre sekretarëve, një zyrtar prej universitetit, një zyrtar prej OJQ-ve, dhe sipas aplikimeve, komisioni formon një listë të ngushtë prej tre personave, ku pastaj ata dërgohen te ministri përkatës për pranimin ose mospranimin. Ministri nëse e pranon ndonjërin, atëherë procedohet më tutje në Qeveri për miratim, nëse nuk pranohet prapë kërkohet ose rishpallja e konkursit, ose anulimi, prandaj për këtë rregullore përgjegjëse është Zyra e Kryeministrit.

Xhavit Haliti, u ndërlidh me atë se nëse konkursi që shpallet dhe e zgjidhni personin në bazë të kualifikimit, por atë mund t'ua prishë ministri, atëherë pse ju të shpallni konkursin, pse nuk e shpall ministri dhe mos t'ju lodh juve. Ju e keni një ligj dhe ju duhet ta zbatoni atë, por nëse ministri iu thotë prapë shpalleni konkursin, atëherë çka jeni ju në këtë rast, jeni një nëpunës i ministrisë përkatëse apo jeni ministër, andaj këtë çështje rregullojeni me ligj që të mos ketë probleme për të ardhmen, sepse tani janë të ngatërruara dhe mos të keni problem edhe me opinionin, për shkak të lidhjeve ose moslidhjeve me subjekte politike, ose me nepotizma të ndryshëm.

Ministri, pajtohet me diskutimin e z. Haliti, por tha se në ligj thuhet se ministri përkatës propozon kandidatin e preferuar.

Xhavit Haliti, theksoi se në demokraci ministri ndërron strukturat politike të një dikasteri, por jo edhe të administratës, ndërsa nëse është ashtu si thoni ju ministër, atëherë duhet amendamentuar ligjin.

Ministri, tha se jo vetëm kjo çështje, por janë edhe disa çështje tjera që duhet të plotësohen me ligj, edhe pse ka pak raste, kur ministrat kërkojnë anulimin e konkursit, por prapë ka.

Sa i përket inspektoratit, nuk ekziston, por janë punonjësit të cilët shqyrtojnë lëndët të cilat vijnë, por nuk dalin në terren. Ne edhe gjatë mandatit të kaluar kemi propozuar Ligjin për inspektimin administrativ dhe këtë mandat besojmë se shpejti ta procedojmë. Ky ligj do të jetë i nevojshëm, nëse miratohet Ligji për paga për të gjithë, sepse duhet bërë një kontrollim edhe sa i përket pagave dhe klasifikimit, përvojës së punës, dokumentacionit dhe çështjeve tjera.

Sa i përket përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë, kemi të dhëna dhe brenda dy javëve, do t'i dorëzojmë raportet për gjendjen në shërbimin civil, por këto të dhëna nuk janë të besueshme, sepse me shfrytëzimin e plotë të sistemit të menaxhimit të resurseve njerëzore, do të kemi shumë më shumë të dhëna dhe të gjitha të dhënat do të jenë në dispozicion në çdo kohë.

Sa i përket përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë, në mandatin e kaluar janë punuar disa dokumente për realizimin e procedurës e cila është paraparë në Ligjin për shërbyesit civilë dhe për sferat tjera duhen edhe disa mekanizma tjerë konkretë, t'i bëjmë përmes inspektoratit për ta ruajtur mekanizmin e përfaqësimit në nivelin qendror dhe nivelin lokal. Në nivelin qendror është 10%, kurse në nivelin lokal është sipas përqindjes së komuniteteve.

Lidhur me pyetjen se a ka punësime pa konkurs, ai tha se në shërbimin civil nuk e besoj se ka pa konkurs, sepse çdo konkurs kalon edhe përmes neve, edhe përmes Këshillit Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, por mund të ndodh në fusha tjera, sepse mungon inspektimi.

Në shërbimin civil nuk ka punëtorë të cilët punojnë pa përshkrim të vendeve të punës.

Sa i përket përkrahjes nga Shqipëria, ekziston mundësia e organizimit të trajnimeve për shërbyesit civilë dhe bashkëpunimi në hartimin e strategjive dhe bashkëpunimi i kuadrove, si dhe përvojave. Tek shërbyesit civilë, pagesa është gati e njëjtë dhe ndoshta ende ka raste që nuk janë të njëjta, prandaj edhe ky ka qenë qëllimi që është hartuar katalogu i vendeve të punës, të bëhet klasifikimi dhe koeficienti të jetë i bazuar në ligj.

Sa i përket pagës bazë te inspektoratet, mund të ndodhin dallime, sepse varet prej vlerësimit se a është inspektorati në nivelin e agjencisë apo të departamentit. Nëse është në nivel agjencie, kryeinspektori e ka pagën shumë më të lartë sesa në nivelin e departamentit.

Kryetarja falënderoi ministrin për raportimin e tij dhe shtoi se mbetën edhe disa përgjigje të dërgohen me shkrim dhe me këtë e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Znj. Teuta Sahatqija
